

KONTRATË SHITJE KUOTASH KAPITALI

TË SHOQËRISË "BIG TRENI" SH.P.K

Sot me date 29.03.2024 ortaku i shoqërisë BIG TRENI shpk, Vladimir Lleshaj dhe e interesuara shoqëria B-Ideal Group e përfaqësuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj u mbledhën për të nënshkruar kontratën e shitjes së kuotave ku:

SHITESI:

Vladimir Lleshaj, i datelindjes 08.04.1978 pajisur me kartën e identitetit H80408150T, zotërues i 49 kuotave ekuivalente me 49% të kapitalit me vlerë 1 470 000 leke.

BLERESI:

Shoqëria B-Ideal Group pajisur me NIPT M31722025S e përfaqësuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues I tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord të nënshkruajnë Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "BIG TRENI" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Neni 1

Marreveshja themelore

Shoqëria "BIG TRENI" sh.p.k, është regjistruar në QKB e pajisur me NIPT L41617022M, me seli: Bulevardi Zogu i I-rë, Kati Përdhe i Godinës 9 - Katëshe të Shoqërisë "Agimi", Tirane, me ortake si më poshte:

Vladimir Lleshaj zotërues i 49 kuotave ekuivalente me 49% të kapitalit me vlerë 1 470 000 leke

Shoqëria BIGALB GROUP e përfaqësuar nga administratori i saj Znj. Elona Koshi zotëruese e 51 kuotave ekuivalente me 51% të kapitalit me vlerë 1 530 000 leke



Ne vendimin date 29.03.2024, asambleja e ortakeve te shoqerise ka miratuar shitjen e kuotave te zoteruara nga pala shitese Vladimir Lleshaj ne favor te pales blerese shoqeria B-Ideal Group pajisur me NIPT M31722025S e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj dhe konkretisht:

Pala shitese Vladimir Lleshaj i shet pales blerese shoqerise B-Ideal Group 49 kuota qe perfaqeson pjesmarrjen ne perqindje 49% te kapitalit te shoqerise "BIG TRENI" shpk.

Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe menyra e likujdimit

Çmimi i plotë i shitjes së kuotave është 1 470 000 si me poshte:

Vladimir Lleshaj ka rene dakort ti shesi pales blerese shoqerise B-Ideal Group nëpërmjet shitjes se 49 kuotave qe perfaqesojne 49% te kapitalit te shoqerise, kundrejt cmimit 1 470 000 leke shume e cila eshte likjuar nga pala blerese ne favor te pales shitese.

Pas ketij veprimi, shoqeria do do te kete 100 kuota qe do te zoterohen nga ortaket si me poshte:

Shoqeria B-Ideal Group zoteruese e 49 kuotave ekuivalente me 49% te kapitalit me vlere 1 470 000 leke

Shoqeria BIGALB GROUP zoteruese e 51 kuotave ekuivalente me 51% te kapitalit me vlere 1 530 000 leke

Neni 3

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

Kontrata do te regjistrohet ne QKB qysh ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate ndersa Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësi te Blerësit do të kryhet menjehere.



Fq. 2

Neni 4

Garancitë

Shitësi në lidhje me kuoten që zotëron, garanton Blerësin:

1. Se është pronar i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuota të shitura.
2. Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuota të fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.
3. Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.
4. Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme të shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.
5. Palet shitesë me nënshkrimin e kësaj kontrate, heqin dorë perfundimisht nga pronësia mbi kuotat që shet, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kalojnë palet blerëse.

Neni 5

Regjistrimi

Regjistrimi i kontratës perkalimin e kuotavenga Shitësi të Blerësit në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 6

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.



Neni 7

Dispozitat e fundit

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Kontrata redaktohet ne dy kopje origjinalë konform rregullave dhe ligjeve dhe me vullnet të lirë nënshkruhet nga palët.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITESIT

Vladimir Lleshaj



BLERESI

Shoqeria B-Ideal Group



e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj

Vladimir Lleshaj

